

TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE *dhe*.. NDËRMARRJET

2023



TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE *dhe* NDËRMARRJET

2023



TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE DHE NDËRMARRJET 2023

Drejtor botimi: **Dr. Elsa Dhuli**

© Copyright INSTAT 2024

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij
në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim
të mbajtësit të së drejtës së autorit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 2233356 / 2222411 4 355
Fax: 411 2222 4 355+
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

Dizajn: Gentian Suçi

PARATHËNIE DHE MIRËNJOHJE

Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), hartoi një publikim të veçantë për treguesit kryesorë mbi tregtinë e jashtme të mallrave dhe tregtinë e mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjes. Duke iu referuar periudhës nga viti 2018-2022, statistikat në lidhje me tregtinë e mallrave synojnë të monitorojnë karakteristikat dhe zhvillimet e tregtisë vendin tonë me botën.

Në strategjinë e re të komunikimit, INSTAT është orientuar që të përmbushë nevojat e përdoruesve duke targetuar grupe të ndryshme përdoruesish.

Materiali pasqyron disa nga kërkesat themelore dhe nevojat e disa grupeve të përdoruesve për të dhënat mbi tregtinë e mallrave dhe ndikimin e tyre në ekonominë shqipëtare.

Ky publikim i dedikuar, paraqet me anë të shifrave realitetin ekonomik në vend si dhe përgjigjet ndaj kërkesave në rritje për informacion statistikor të vendimarrësve, kërkuesve shkencor dhe akademikëve në Shqipëri. Përgatitja e këtij materiali është mundësuar falë bashkëpunimit dhe të dhënave administrative të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera dhe politikë-bërësit, rrit përgjegjësinë e INSTAT për hartimin e publikimeve të veçanta dhe informacioneve statistikore që do të shërbenin për të kuptuar më mirë realitetin ekonomik në mënyrë që të ballafaqohemi me sfidat e së ardhmes.

INSTAT gjithmonë do të ofrojë partneritet të vazhdueshëm dhe një bashkëpunim të frytshëm, ashtu siç e dëshmon dhe ky botim.

Dr. Elsa DHULI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



PËRMBAJTJA

HYRJE	8
I. KARAKTERISTIKAT E TREGTISË SË JASHTME TË MALLRAVE, 2019-2023	10
A. Tregtia e jashtme e mallrave	10
B. Tregtia e jashtme e mallrave sipas produkteve	10
C. Tregtia e jashtme e mallrave sipas rajoneve kryesore	12
D. Tregtia sipas partnerëve kryesorë	12
II. TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE SIPAS KARAKTERISTIKAVE TË NDËRMARRJES, 2019-2023	13
A. Tregtia e jashtme e mallrave sipas madhësisë së ndërmarrjes	13
B. Sektorët mbizotërues në eksportet/importet e mallrave	14
C. Eksportet/importet e ndërmarrjeve sipas produkteve	15
D. Përqëndrimi i ndërmarrjeve eksportuese/importuese	15
E. Ndërmarrjet eksportuese/importuese, sipas numrit të vendeve partnere	16
ANEKSI 1	17
METODOLOGJI	17

HYRJE

Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave janë një instrument shumë i rëndësishëm për marrësit e vendimeve në sektorët publik dhe privat. Ato ndihmojnë në përgatitjen e bisedimeve bilaterale dhe multilaterale në kuadrin e politikave tregtare dhe për vlerësimin e ekonomive të tregut. Ato ndihmojnë gjithashtu kompanitë në studimin e tregut dhe në përcaktimin e strategjive të tyre tregtare. Statistikat mbi tregtinë e mallrave përmbajnë të dhëna mbi eksportet/importet e mallrave në Shqipëri, si edhe statistika të tregtisë së mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve.

Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve përmbajnë informacion thelbësor mbi ndërmarrjet të cilat marrin pjesë në tregun ndërkombëtar dhe karakteristikat e tyre si: vlerat e eksporteve/importeve dhe numri i ndërmarrjeve. Nëpërmjet lidhjes së statistikave të tregtisë së jashtme të mallrave me statistikën e ndërmarrjeve kuptojmë kontributin e sektorëve të ndryshëm ekonomikë, si dhe pjesëmarrjen e ndërmarrjeve e vogla, të mesme dhe të mëdha në transaksionet tregtare. Hartimi i statistikave të tregtisë së jashtme të mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve kryhet përmes lidhjes në nivel individual të të dhënave të tregtisë së mallrave me regjistrin statistikor të ndërmarrjeve. Karakteristikat kryesore të ndërmarrjeve nga regjistri statistikor i ndërmarrjeve – si aktiviteti ekonomik dhe numri i të punësuarve – janë të kombinuara me variablat tipikë të të dhënave të tregtisë së mallrave si kodi i produktit dhe vendi partner, duke na dhënë në këtë mënyrë një pamje më të plotë të strukturës së tregtisë së mallrave.

Duke iu referuar periudhës 2019-2023, statistikën në lidhje me tregtinë e mallrave në Shqipëri synojnë të monitorojnë karakteristikat dhe zhvillimet e tregtisë së vendit tonë me botën.

Ky material, i përgatitur nga INSTAT, publikohet i strukturuar në këtë mënyrë, duke përfshirë të dhënat për vitet referencë 2019-2023 dhe do të jetë publikim i vazhdueshëm me frekuencë vjetore.

Materiali përbëhet nga dy kapituj. Kapitulli i parë paraqet informacion mbi shkëmbimin e mallrave ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të tjera të botës.

Kapitulli i dytë ka për objektiv të paraqesë statistika mbi tregtinë e jashtme të mallrave të detajuar sipas kategorive të ndryshme të ndërmarrjeve.

GJETJET KRYESORE

Në vitin 2023 eksportet e mallrave janë 440 miliard lekë, duke u ulur 9,5 % krahasuar me vitin 2022 dhe duke u rritur me 47,4 % krahasuar me 2019. Ndërsa importet e mallrave arritën vlerën 873 miliard lekë, duke u ulur 8,2 % krahasuar me vitin 2022 dhe duke u rritur me 34,4 % krahasuar me 2019.

Në vitin 2023 pesha e eksporteve në vendet e BE është 72 % të eksporteve të mallrave, duke arritur vlerën 316 miliard lekë. Eksportet në vendet e BE u ulën me 11,5 % krahasuar me vitin 2022 dhe u rritën me 38,6 % krahasuar me 2019. Ndërsa pesha e importeve nga vendet e BE është 51 % të importeve të mallrave, duke arritur vlerën 444 miliard lekë. Importet nga këto vende u ulën me 9,4 %, krahasuar me vitin 2022 dhe u rritën me 18,9 % krahasuar me 2019.

Në vitin 2023 partneri ynë kryesor për eksportet dhe importet vazhdon të jetë Italia. Vlera e eksporteve drejt Italisë është 189 miliard lekë, duke u ulur 10,2 % krahasuar me vitin 2022 dhe duke u rritur me 32,1 % krahasuar me 2019. Ndërsa vlera e importeve nga Italia 194 miliard lekë, duke u ulur 5,9 % krahasuar me vitin 2022 dhe duke u rritur me 18,0 % krahasuar me 2019.

Numri i ndërmarrjeve eksportuese në vitin 2023 është 3.792, duke u rritur me 5,2 % krahasuar me vitin 2022 dhe 18,9 % krahasuar me 2019. Ndërsa numri i ndërmarrjeve importuese është 13.653 ndërmarrje, duke u rritur me 3,9 % krahasuar me vitin 2022 dhe 20,1 % krahasuar me 2019.

Në vitin 2023, ndërmarrjet që operojnë në industri dominojnë ndërmarrjet eksportuese. Këto ndërmarrje kryejnë 81 % të vlerës së eksporteve, duke u ulur me 10,4 % krahasuar me vitin 2022 dhe duke u rritur me 17,1 % krahasuar me 2019. Ndërmarrjet që operojnë në tregti dominojnë ndërmarrjet importuese në vitin 2023. Këto ndërmarrje kryejnë 59 % të vlerës së importeve, duke u ulur me 4,1 % krahasuar me 2022 dhe duke u rritur me 40,8 % krahasuar me 2019.

Për vitin 2023, më shumë se gjysmën e eksporteve e kryejnë 100 ndërmarrjet më të mëdha (58 %), ndërsa më shumë se gjysmën e importeve e kryejnë 200 ndërmarrjet më të mëdha (51 %).

Në vitin 2023, dominojnë ndërmarrjet që eksportojnë drejt 1 vendi partnere. Ato kryejnë 28 %, të vlerës së eksporteve, ndjekur nga ndërmarrjet që eksportojnë drejt 10 ose më shumë vende partnere (23 %).

Në vitin 2023, dominojnë ndërmarrjet që importojnë nga 10 ose më shumë vende partnere. Këto ndërmarrje kryejnë 59 % vlerës së importeve, ndjekur nga ndërmarrjet që importojnë nga 6-9 vende partnere (13 %).

KARAKTERISTIKAT E TREGTISË SË JASHTME TË MALLRAVE, 2019-2023

A. Tregtia e jashtme e mallrave

Gjatë vitit 2023 defiqiti tregtar është përmirësuar duke u ulur 6,7 % krahasuar me vitin 2022 dhe përkeqësuar duke u rritur 23,4 % krahasuar me 2019.

Gjatë periudhës 4-vjeçare (2019-2022) vihet re një tendencë rritje e eksporteve dhe importeve. Në vitin 2023 pesha e eksporteve është 34 %, duke u ulur 9,5 % krahasuar me vitin 2022 dhe duke u rritur 47,4 % krahasuar me 2019. Ndërsa pesha e importeve në vitin 2023 është 66 %, duke u ulur 8,2 % krahasuar me vitin 2022 dhe duke u rritur me 34,4 % krahasuar me 2019.




Fig.1 Ndryshimi vjetor në tregtinë e jashtme të mallrave, 2019-2023 (%)

B. Tregtia e jashtme e mallrave sipas produkteve

Produktet kryesore

Produktet që zënë një pjesë të konsiderueshme në eksportet dhe importet shqiptare për periudhën 5-vjeçare janë eksportet e mallrave të përpunuara.

Për vitin 2023 më të eksportuara janë grupet e produkteve: "Mallra të përpunuara" me 55 %, duke u ulur me 10,8 % krahasuar me 2022 dhe rritur me 28,6 % krahasuar me 2019, "Lëndët djegëse" me 16 % duke u ulur me 16,1 % krahasuar me 2022 dhe rritur me 2 herë krahasuar me 2019, "Ushqime dhe kafshë të gjalla" me 10 % të eksporteve, duke u rritur me 4,1 % krahasuar me 2022 dhe rritur me 50,4 % krahasuar me 2019, si edhe "Makineri dhe pajisje transporti" me 9 %, duke u ulur me 2,2 % krahasuar me vitin 2022 dhe rritur me 84,7 % krahasuar me 2019.

MALLRA TË PËRPUNUARA
55 %



LËNDËT DJEGËSE
16 %



USHQIME DHE KAFSHË TË GJALLA
10 %



MAKINERI DHE PAJISJE TRANSPORTI
9 %



Tab.1 Eksportet sipas Klasifikimit Standart të Tregtisë së Jashtme (SITC Rev.4), 2019-2023
milione lekë

	2019	2020	2021	2022	2023
Gjithsej	298 792	271 955	368 769	486 784	440 308
Ushqime dhe kafshë të gjalla	28 388	31 227	35 595	41 011	42 689
Pije dhe duhan	1 846	1 710	2 086	3 528	3 992
Materiale të përpunuara	20 582	20 192	25 877	36 980	29 969
Lëndë djegëse	33 322	22 957	50 244	82 539	69 263
Yndyrna bimore dhe shtazore	196	297	390	557	3 281
Produkte kimike	5 357	5 229	7 824	11 213	10 140
Mallra të përpunuara	63 391	61 118	97 654	123 762	103 980
Makineri e pajisje transporti	20 930	22 360	28 744	39 514	38 648
Mallra të tjera të përpunuara	124 562	106 353	119 848	147 095	137 748
Mallra të paklasifikuara diku tjetër	218	513	508	582	598

Grup produktet që dominojnë importin për vitin 2023 janë: “Mallra të përpunuara” me 36 %, duke u ulur me 6,6 % krahasuar me 2022 dhe rritur me 32,5 % krahasuar me 2019, “Makineri dhe pajisje transporti” me 24 %, duke u rritur me 13,8 % krahasuar me 2022 dhe rritur me 55,7 % krahasuar me 2019, si edhe “Ushqime dhe kafshë të gjalla” me 12 %, duke u ulur 2,7 % krahasuar me vitin 2022 dhe rritur me 30,6 % krahasuar me 2019.

Tab.2 Importet sipas Klasifikimit Standart të Tregtisë së Jashtme (SITC Rev.4), 2019-2023
milione lekë

	2019	2020	2021	2022	2023
Gjithsej	649 118	605 262	800 718	950 381	872 676
Ushqime dhe kafshë të gjalla	82 044	82 736	95 762	110 118	107 170
Pije dhe duhan	20 990	19 553	24 964	28 428	30 145
Materiale të përpunuara	22 167	22 368	27 745	22 439	16 531
Lëndë djegëse	73 118	50 808	100 668	164 780	95 353
Yndyrna bimore dhe shtazore	4 192	5 242	5 628	6 710	4 396
Produkte kimike	75 483	77 831	97 803	98 723	96 225
Mallra të përpunuara	145 720	136 208	179 487	227 222	206 227
Makineri e pajisje transporti	135 148	130 737	167 529	184 858	210 381
Mallra të tjera të përpunuara	89 750	79 517	100 687	106 765	105 709
Mallra të paklasifikuara diku tjetër	506	263	447	336	539


C. Tregtia e jashtme e mallrave sipas rajoneve kryesore

Në vitin 2023 pesha e eksporteve në vendet e BE është 72 %, duke u ulur me 11,5 % krahasuar me vitin 2022 dhe rritur me 38,6 % krahasuar me 2019. Ndërsa pesha e importeve nga vendet e BE është 51 % të importeve duke u ulur me 9,4 %, krahasuar me vitin 2022 dhe rritur me 18,9 % krahasuar me 2019.

Pesha e eksporteve në vendet e CEFTA-s është 18 %, duke u ulur me 2,3 % krahasuar me vitin 2022 dhe rritur me 55,1 % krahasuar me 2019. Ndërsa pesha e importeve nga vendet e CEFTA-s është 6 % të importeve duke u ulur me 23,3 %, krahasuar me një vit më parë dhe rritur me 25,0 % krahasuar me 2019.

Fig.2 Tregtia e mallrave sipas grupvendeve, 2023

	Eksporte	Importe
Vendet e BE-së	72%	51%
Vendet e CEFTA-s	18%	6%
Vendet e EFTA-s	1%	2%
Vendet e tjera	9%	41%




D. Tregtia sipas partnerëve kryesorë

Tendenda e partnerëve tregtarë, 2023

Eksportet në vlerë kanë shënuar rritje të drejt Kosovës, Greqisë, Kinës, Mali i Zi, Mbretërisë së Bashkuar, etj. Ndërsa rritje për importet kanë Kina, Gjermania, SHBA, Mbretëria e Bashkuar, etj.

Në vitin 2023 partnerët tanë kryesorë për eksportet janë: Italia (43 %) duke u ulur me 10,2 % krahasuar me vitin 2022 dhe rritur me 32,1 % krahasuar me 2019, Kosova (9 %) duke u rritur 8,3 % krahasuar me vitin 2022 dhe rritur me 37,3 % krahasuar me 2019, Greqia (7 %) duke u rritur 13,1 % krahasuar me vitin 2022 dhe rritur me 2 herë krahasuar me 2019.

Ndërsa partnerët kryesorë për importet janë: Italia (22 %) duke u ulur 5,9 % krahasuar me vitin 2022 dhe rritur me 18,0 % krahasuar me 2019, Kina (11 %) duke u rritur 21,0 % krahasuar me vitin 2022 dhe rritur me 57,0 % krahasuar me 2019, Turqia (10 %) duke u ulur 26,2 krahasuar me vitin 2022 dhe rritur me 36,9 % krahasuar me 2019.



TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE SIPAS KARAKTERISTIKAVE TË NDËRMARRJES, 2018-2022

A. Tregtia e jashtme e mallrave sipas madhësisë së ndërmarrjes

Në periudhën 2019-2023, numri i ndërmarrjeve eksportuese dhe importuese është rritur. Numri i ndërmarrjeve eksportuese, në vitin 2023, është 3.792, duke u rritur me 5,2 % krahasuar me vitin 2022 dhe rritur me 18,9 % krahasuar me 2019. Në vitin 2023, pesha e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, është 97 %. Pesha e ndërmarrjeve mikro është 49 %, ndërmarrjet e vogla është 34 %, ndërmarrjet e mesme është 14 % dhe ndërmarrjet e mëdha është 3 %.


Në vitin 2023, numri i ndërmarrjeve importuese është 13.653 ndërmarrje, duke u rritur me 3,9 % krahasuar me një vit më parë dhe rritur me 20,1 % krahasuar me 2019. Pesha e ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme është 99 % të ndërmarrjeve importuese gjithsej. Pesha për ndërmarrjet mikro (1-9 të punësuar) është 68 %, ndërmarrjet e vogla është 23 % të ndërmarrjeve importuese gjithsej, ndërmarrjet e mesme është 7 % dhe ndërmarrjet e mëdha është 1 %.



Ndërmarrjet mikro:
1-9 të punësuar,



Ndërmarrjet e vogla:
10-49 të punësuar,



Ndërmarrjet e mesme:
49-250 të punësuar,



Ndërmarrjet e mëdha:
250+ të punësuar.




Fig.3 Ndërmarrjet, sipas madhësisë së ndërmarrjes, 2023

B. Sektorët mbizotërues në eksportet/ importet e mallrave

Industria përfshin:

Industri nxjerrëse; Industri përpunuese; Energji elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar; Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve

Për periudhën 2019-2023, në ndërmarrjet eksportuese mbizotërojnë, ndërmarrjet që operojnë në sektorin e industrisë. Në vitin 2023, pesha e eksporteve të kryera nga ndërmarrjet që operojnë në industri është 81 %, duke u ulur me 10,4 % krahasuar me vitin 2022 dhe rritur me

17,1 % krahasuar me 2019. Ndërmarrjet e mëdha zënë 39 % të vlerës së eksporteve të këtyre ndërmarrjeve, duke u ulur me 11,5 % krahasuar me vitin 2022 dhe rritur me 18,3 % krahasuar me 2019.

Për periudhën 2019-2023, vlerën më të madhe të importeve e kanë ndërmarrjet që operojnë në sektorin e tregtisë. Në vitin 2023, pesha e këtyre ndërmarrjeve është 59 %, duke u ulur me 4,1 % krahasuar me 2022 dhe rritur me 40,8 % krahasuar me 2019.

Në 2023, ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme zënë 89 % të vlerës së importeve të ndërmarrjeve që operojnë në sektorin e tregtisë, duke u ulur me 5,1 %, krahasuar me vitin 2022 dhe rritur me 37,2 % krahasuar me 2019.




Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas sektorëve, 2023 (%)

C. Eksportet/importet e ndërmarrjeve sipas produkteve

“Produktet nga përpunimi”, në periudhën 2019-2023 zënë pjesën më të madhe të produkteve të eksportuara dhe të importuara. Në vitin 2023, pesha e eksporteve të këtyre produkteve është 76 %, duke u ulur me 7,3 %, krahasuar me 2022 dhe rritur me 36,6 % krahasuar me 2019. Produktet me peshën kryesore në “Produktet nga përpunimi” janë: “Produktet e veshjeve” (20 %), “Produktet e metaleve bazë” (17 %) dhe “Produktet e përpunimit të lëkurës” (17 %).

Ndërsa pesha e importeve të produkteve nga përpunimi është 87 %, duke u ulur me 4,1 %, krahasuar me 2022 dhe rritur me 39,6 % krahasuar me 2019. Produktet me peshën kryesore në “Produktet nga përpunimi” janë: “Produktet ushqimore” (11 %) dhe “Koks dhe nënprodukte të naftës të rafinuara” (9 %).

Produktet që zënë një pjesë të konsiderueshme në eksportet dhe importet shqiptare për periudhën 5-vjeçare janë eksportet e mallrave të përpunuara.

D. Përqëndrimi i ndërmarrjeve eksportuese/importuese

Në periudhë 2019-2021, më shumë se gjysma e eksporteve ishte e përqëndruara në 50 ndërmarrjet më të mëdha. Për vitet 2022-2023, më shumë se gjysma e eksporteve ishte e përqëndruara në 100 ndërmarrjet më të mëdha, ku në 2023 pesha e tyre ishte 58 %. Pesha e këtyre ndërmarrjeve që operojnë në industri është 69 %, ndërsa pesha e ndërmarrjeve që operojnë në tregti është 74 %.

Në periudhë 2019-2020, më shumë se gjysma e importeve ishte e përqëndruara në 100 ndërmarrjet më të mëdha. Për vitet 2021-2023 më shumë se gjysmën e importeve e kryejnë 200 ndërmarrjet më të mëdha. Pesha e këtyre ndërmarrjeve, për vitin 2023, ishte 51 %. Pesha e këtyre ndërmarrjeve që operojnë në industri është 78 %, ndërsa pesha e ndërmarrjeve që operojnë në tregti është 59 %.




Fig.5 Eksportet/importet e ndërmarrjeve sipas produkteve, 2023 (%)





Fig.6 Tregtia e jashtme e mallrave sipas ndërmarrjeve kryesore, 2023

E. Ndërmarrjet eksportuese/importuese, sipas numrit të vendeve partnere

Në periudhë 2019-2023, pjesën më të madhe të eksporteve ndërmarrjet e kryejnë vetëm me 1 vend partner. Në vitin 2023, ndërmarrjet që eksportojnë drejt 1 vendi partner (28 %), ndjekur nga ndërmarrjet që eksportojnë vetëm me 10 ose më shumë vende partnere (23 %).

Ndërsa pjesën më të madhe të importeve, në periudhë 2019-2023, ndërmarrjet e kryejnë me më shumë se 10 vende partnere. Në vitin 2023, pesha e importeve të këtyre ndërmarrjeve është 59 %, ndjekur nga ndërmarrjet që importojnë nga 6-9 vende partnere (13 %).



ANEKSI 1:


Metodologji

Burimi i informacionit

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është burimi i të dhënave të tregtisë së jashtme të mallrave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është burimi i të dhënave për Regjistrin e Ndërmarrjeve.

Grumbullimi i të dhënave

Në nivelin konceptual, metodologjia e përdorur në grumbullimin dhe vlefshmërinë e të dhënave mund të shpjegohet sipas skemës në vazhdim:



PËRKUFIZIME / KONCEPTE

Përkufizimet dhe konceptet në këtë shpjegues metodologjik janë dhënë në mënyrë të tillë që të pasqyrojnë lidhjen ndërmjet përmbajtjes së të dhënave të tregtisë së mallrave dhe regjistrit të ndërmarrjeve.

Ndërmarrja është: “kombinimi më i vogël i një-sive ligjore pra një njësi organizative që prodhon të mira apo shërbime që ka një farë autonomie në marrjen e vendimeve, veçanërisht për shpërndarjen e burimeve aktuale të saj. Ndërmarrja kryen një ose me shumë aktivitete në një apo më shumë vendndodhje (njësi lokale)”. Marrëdhënia ndërmjet një ndërmarrje dhe një njësie ligjore përkufizohet si: “ndërmarrja i korrespondon ose një njësie ligjore ose një kombinimi njësisht ligjore”.

Vendi partner në termat e eksporteve është vendi i destinacionit final të mallrave. Për importet është vendi i origjinës së mallrave.

Vendet anëtare të BE – Austri, Belgjikë, Bullgari, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Greqi, Gjermani, Hollandë, Hungari, Irlandë, Itali, Kroaci, Letoni, Lituani, Luksemburg, Maltë, Poloni, Portugali, Qipro, Republika Çeke, Rumani, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Suedi;

Vendet anëtare të CEFTA – Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedoni, Moldavia, Serbia, Shqipëria;

Vendet anëtare të EFTA – Island, Norvegji, Lihtenshtein, Zvicër.

Eksportet janë vlerësuar me FOB (Përfaqëson një kusht të shpërndarjes së mallrave, që tregon se çmimi i mallrave përfshin edhe shpenzimet e transportit dhe të dorëzimit, tek një port i caktuar i ngarkimit). Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, të përpunimit pasiv, të rieksportuara pas përpunimit aktiv.

Importet janë vlerësuar me CIF (Përfaqëson një kusht të shpërndarjes së mallrave, që tregon se çmimi i mallrave përfshin sigurimin dhe transportin, deri tek një port i caktuar destinacion).

Klasifikime

Në përpunimin e informacionit statistikor të tregtisë së jashtme të mallrave, import-eksportet, është përdorur Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Tregtisë (SITC), i cili i klasifikon mallrat sipas fazave të tyre të prodhimit. Ndërsa për aktivitetet klasifikimi i aktiviteteve ekonomike NVE rev.2 (emërtimi shkurt në anglisht – NACE Rev.2) dhe për produktet klasifikimi statistikor i produkteve sipas aktiviteteve, NP 2008 (emërtimi shkurt në anglisht – CPA 2008).

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

INSTAT

Tregtia e jashtme e mallrave dhe ndërmarrjet : 2023
/ Instituti i Statistikave ; drejt. bot. Elsa Dhuli. - Tiranë
: INSTAT, 2024.

...f. : me il. ; ... cm.

ISBN 9789928390196

1.Tregtia e jashtme 2.Statistika 3.Shqipëri

311.312(496.5) "2023" :339.5



TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE *dhe* NDËRMARRJET

2023

INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave